

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA VLADA / GOVERNMENT
 MINISTERIA E FINANCËVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE / MINISTARSTVO FINANSIJA, RADA I TRANSFERA -
 MINISTRY OF FINANCE, LABOUR AND TRANSFERS

02/401
 2323/2025
 28/07/25

PRISHTINE / PRISTINA / PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANUAR/DREZUAR:
 DATUM PRILJEMOŠTAVLJEN:
 DATE RECEIVED/SUBMITTED: 29 07-2025

Njësia Org. Org. Jeçin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	1348	7

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelaria Generalni Sekretara - Secretary General's Office

DATË/A:	15.07.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Vlora Mehmeti, Auditore e Përgjithshme
CC:	Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit Alban Beka, Udhëheqëse e ekipit të Auditimit Nuhi Mani, Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i veprimit për zbatim të rekomandimeve dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit



E nderuara znj. Mehmeti,

Bashkangjitur gjeni Raportin e zbatimit të rekomandimeve, të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin fiskal 2024.

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të reko.	Komente
1	Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore	Vonesë në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor nga ATK	Ministri duhet të sigurojë përmes drejtorit të ATK-së menaxhim efikas në procesin e shqyrtimit të kërkesave për kthime/rimbursime, në mënyrë që të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Po ashtu, të analizoj shkaqet që kanë shkaktuar ngecjen, përfshirë kapacitetet aktuale, dhe të ndërmarrë veprime përkatëse për adresimin e tyre duke shtuar fokusin në trajtimin e kërkesave.	ATK e pranon se në disa raste ka pasur vonesa në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se nga viti 2023 afati ligjor për trajtimin e këtyre kërkesave është përgjysmuar, nga 60 në vetëm 30 ditë, duke e rritur ndjeshëm ngarkesën në raport me kapacitetet ekzistuese. Pavarësisht përkushtimit të stafit aktual, një ndër sfidat kryesore mbetet mungesa e resurseve njerëzore, pasi që nga viti 2019 nuk ka pasur rekrutime të reja, duke ndikuar direkt në kapacitetin operativ për përmbushjen e detyrave ligjore brenda afateve të reja të përcaktuara. ATK është në dijeni për këtë sfidë dhe ka adresuar vazhdimisht nevojën për plotësimin e vendeve të lira të punës. Megjithatë, për të përmirësuar gjendjen aktuale, ATK është e gatshme të rishikojë proceset e brendshme dhe të ndërmarrë hapa për rritjen e efikasitetit me burimet ekzistuese, derisa të	Drejtori i ATK-se Zv. Drejtori per Operacine Drejtori per Rimbursime	Viti fiskal 2025	Rekomandimi do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025

				krjohen kushtet për plotësimin e nevojave me staf të ri.			
2		Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale	Ministri duhet të iniciojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.	Do të bëhet një analizë lidhur me nevojën për ndryshime ligjore dhe për një opinion ligjor lidhur me këtë problematikë.	Zyra e Sekretarit, DNS, DP dhe Departamenti Ligjor	Viti fiskal 2025	Ky rekomandim do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025
3		Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontroleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.	Bazuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Nr. 11-06-4117, të datës 18.10.2019, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2010 për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemës së Ndihmës Sociale të fituar pa bazë ligjore. Departamenti i Skemave Sociale (DSS) dhe Divizioni i Ndihmës Sociale (DNS) realizojnë në baza mujore krahasimin e të dhënave ndërmjet listës së përfituesve të ndihmës sociale dhe regjistrit të tatimpaguesve në ATK. Nga ky proces i krahasimit, çdo muaj identifikohen më së shumti 130 raste të familjeve që kanë përfitur ndihmë sociale pa	Zyra e Sekretarit, DSS/DNS, DP dhe Departamenti Ligjor	Viti fiskal 2025	Rekomandimi do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025

				<p>baze ligjore, duke qenë se kanë realizuar të hyra financiare mbi 80.00 euro në muaj nga punësimi në kompani të ndryshme. Arsyeja e kësaj mospërputhjeje qëndron në faktin se kompanitë përkatëse nuk i kanë deklaruar këta punëtorë në ATK deri më datën 15 të muajit vijues, duke bërë që MFPT në momentin e ekzekutimit të pagesës së ndihmës sociale të mos ketë informacion mbi të hyrat e tyre.</p> <p>Në momentin kur DSS/DNS merr informatat nga ATK për këto raste, të gjitha familjet që janë evidentuar me të hyra mbi pragun e lejuar ligjor, largohen nga skema e ndihmës sociale në muajin vijues.</p> <p>Për këtë arsye, nga Qendrat për Punë Sociale (QPS) kërkohet që, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2010, të iniciojnë procedurat për kthimin e pagesave të ndihmës sociale për muajt gjatë të cilëve është vërtetuar se përfilimi në kundërshtim me bazën ligjore.</p>			
4		Pagesa e furnizimeve para pranimit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së duhet të forcojnë kontrollët e brendshme dhe të sigurohen se	ATK, është e fokusuar në respektimin procedurave ligjore që e dëshmon edhe në këtë rast (përmes	Drejtori i ATK-së Drejtori për Shërbime të Përgjithshme	Viti fiskal 2025	Rekomandimi do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025

			<p>praktikat e tilla të pagesave nuk aplikohen në të ardhmen. Po ashtu, para ekzekutimit të çdo pagese të sigurohen se janë pranuar furnizimet me qëllim që të arrihen objektivat për të cilin është shpenzuar paraja publike.</p>	<p>Ligjit për mardhënje detyrimore nën 2, nën 4, nën 5, nën 8, nën 10 dhe nën 217), ballafaqimi me mungesë të automjeteve, pas skadimit të kontratës me lizëzim si dhe automjeteve të vjetra me vit të prodhimit 1999-2000. Rreziku për sigurinë e jetës së stafit dhe pjesëmarrësve në komunikacion ka qenë e vërtetë. Nuk ka pasur mjete të mjaftueshme buxhetore të ndara për vitin buxhetor 2025. Pagesa është bërë për një rast të veçantë dhe të justifikuar, i cili është mbështetur me dëshmi nga prodhuesi dhe garanci bankare të pagueshme me kërkesën e parë, pa cenim të parasë publike dhe të mirës publike.</p>	Menaxheri i Prokurimit		
5		Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.</p>	<p>Gjatë vitit 2025 do të ketë një qasje më gjithëpërfshirëse lidhur me klasifikimin e shpenzimeve.</p>	<p>Zyra e Sekretarit, APRK, Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Departamenti i Administratës</p>	Viti fiskal 2025	<p>Ky rekomandim do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025</p>
6		Mos kryerja e procesit të inventarizimit	<p>Ministri duhet të sigurojë se para përgatitjes së</p>	<p>Gjatë vitit 2025 do të ketë një qasje më gjithëpërfshirëse</p>	<p>Zyra e Sekretarit,</p>	Viti fiskal 2025	<p>Ky rekomandim do të gjejë</p>

		të pasurisë me kohë	pasqyrave financiare të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë në kuadër të MFPT-së si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV për vitin 2025.	lidhur me pasuritë dhe do të adresohen të gjitha mangësitë.	Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Departamenti i Administratës.		zbatim gjatë vitit fiskal 2025
7		Mangësi në regjistrimin e pasurive.	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MFPT-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e drejtë dhe e saktë.	Është regjistruar pasuria kapitale sipas të gjeturave të Auditorit të Jashtëm në e-pasuria dhe në SIMFK.	Zyrtari i pranimit të mallit dhe zyrtari i pasurisë	Viti fiskal 2025	Është përfunduar
8		Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra	Ministri përmes Drejtorit të ATK-së duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra, apo të ndërmirren veprime konkrete që kjo çështje të rregullohet me bazë ligjore përkatëse.	ATK ka funksionalizuar një sistem të ri dhe efikas të menaxhimit të borxheve, i cili ka përmirësuar ndjeshëm procesin e ndjekjes dhe mbledhjes së borxheve aktive. Ky sistem ka sjellë më shumë kontroll dhe transparencë në menaxhimin e obligimeve tatimore. Megjithatë, sfida mbetet stoku i vjetër i borxheve, i cili	Drejtori i ATK-së ZV Drejtori për Operacine Drejtori për DMMB	Viti fiskal 2025	Rekomandimi do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025

				<p>është trashëguar ndër vite dhe përfshin raste me mungesë dokumentacioni, procedura të papërfunduara dhe pa vendime të nevojshme ligjore. Kjo e vështirëson frajtimin e tyre, përfshirë edhe marrjen e vendimeve për anulim, çka ndikon në pamundësinë për të ulur stokun në mënyrë efektive. Po ashtu, numri i kufizuar i stafit dhe mungesa e rekrutimeve të reja që nga viti 2019 kanë ndikuar në ngarkesën e lartë të punës, sidomos në njësitë që merren me borxhet aktive, duke e bërë të pamundur një fokus të njëjtueshëm të borxhet e vjetra.</p>			
9		<p>Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente</p>	<p>Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontingjente të mbahen të saktë dhe të azhuruar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.</p>	<p>Të rishikohet lista e kontingjenteve të akumuluar ndër vite nga Departamenti Ligjor, Sektori i Përfaqësimeve dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave, që të përcaktohet sa më saktë shuma e kontingjenteve e cila shumë/vlerë është dinamike.</p>	<p>Departamenti Ligjor, Departamenti i Pensioneve dhe Ndihmave Sociale si dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave</p>	<p>Kemi ndërmarr masa të menjëhershme lidhur me zbatimin e kësaj të gjeture</p>	<p>Rekomandim do të gjejë zbatim gjatë vitit fiskal 2025</p>

